

## NJOFTIM

### **Licencimi i Aktivitetit të Furnizimit me Shumicë (Trgtimit) të Energjisë Elektrike në Kosovë**

**Ndërmarrja GSA Energji sh.p.k. me adresë Rr. Xheladin Hana, OBJ 35/15, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës,** në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj **NJOFTON** palët e interesit se ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji për licencim të aktivitetit të **furnizimit me shumicë (trgtimit)** në Kosovë të energjisë elektrike në Kosovë. Aplikacioni për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (trgtimit) të energjisë elektrike, me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjës të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimmarrje.

Licencimi i furnizimit me shumicë (trgtimit) të energjisë elektrike, i ndërmarrjes **GSA Energji sh.p.k.** përveç tjerash do të përmbajë:

- Territori i mbuluar nga Licenca është Republika e Kosovës.
- I licencuari ka të drejtë të blej, shes, ri-shes, importoj dhe eksportoj energji elektrike.
- I licencuari ka të drejtë të shes energji konsumatorëve fundor, të faturoj dhe inkasoj të hyra për energjinë e shitur, si dhe të sigurojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë konsumatorëve.

I licencuari mund të kryej aktivitetin e furnizimit me shumicë (trgtimit) të energjisë elektrike në pajtim me dispozitat e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë. Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. Bekim Fehiu (ish Ndërtesa e Fazitës) Kati II, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: [hrexhaj@ero-ks.org](mailto:hrexhaj@ero-ks.org); Tel.038247615/118/045787077.

**GSA Energji sh.p.k.**

**Rr. Xheladin Hana, OBJ 35/15, 10000, Prishtinë**